




K0222415

ATTESTATION BY THE PRESIDING OFFICER PURSUANT TO
RULE 92 BIS(B)



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Penal
International pour
ex-Yugoslavie

I, RICHARD - J. ROGERS, Presiding Officer appointed by the Registrar of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia on 28 February 2002 pursuant to Rule 92 bis of the Rules of Procedure and Evidence, with the assistance of a certified interpreter, certify;

that on 14 March 2002 in Gjakove, Kosovo

the following person appeared:

Witness's First and Last name(s): MARTIN PNISHI

Date and Place of Birth: 9/3/44, Ramoc, Gjakove Municipality, Kosovo

Identity-, or ~~Passport~~ No.: 1001293474

Habitual Residence: Meje, Gjakove

14 March 2002

- that in the attached statement dated 4 April 2000 and certified by the undersigned on 14 March 2002 the said, Martin PNISHI is identified as his (her) author;
- that the above-mentioned witness was provided with a version of the said statement in a language that he (she) understands;
- that the above-mentioned witness was informed, in a language that he (she) understands, by the Presiding Officer that if the contents of the written statement are not true to the best of his (her) knowledge and belief then he or she may be subject to proceedings for giving false testimony;
- that the above-mentioned witness was provided with a text of Rule 91 of the Rule of Procedure and Evidence, in a language he (she) understands;



K0222416

- that above-mentioned witness declared that the content of his (her) written statement are true and correct to the best of his (her) knowledge and belief;
- that no pressure was brought to bear on the witness and that he (she) voluntarily signed the attached declaration dated 14 March 2002 _____;
- that the following persons were present during the said declaration:

Richard Rogers, Presiding Officer
Kenneth Ekdahl, Investigator, OTP
Elir Selmarusaj, Field interpreter, OTP

Additional remarks:

Witness declared to two statements dated 7/4/2000 and 14/3/2002, the second being an addendum to the first. Statements and declaration were read to the witness in Albanian, by the interpreter.






ATTESTATION BY THE PRESIDING OFFICER PURSUANT TO RULE 92 BIS(B)

Done this 14 March 2002

K0222417


At Gjakove, Kosovo

Signature of the Presiding Officer





United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Penal
International pour
l'ex-Yugoslavie

K0222418

**DEKLARATË NGA PERSONI QË JEP DEKLARATË TË
SHKRUAR NË BAZË TË RREGULLIT 92 BIS**

I,

Emr-i/at dhe mbiemr-i/at: MARTIN PNISHI

Data dhe Vendi i Lindjes: 09. 03. 1944, RAMOC

Nr i dokumentit identifikues ose pasaportës: 1001293474

këtu me këtë konfirmoj, në prani të Zyrtarit Kryesues RICHARD ROGERS

se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave së/të shkruar/a që unë bëra më 04.04.2000 DHE 14.03.2002

dhe e/të cila/t tani i është/janë bashkëngjitur kësaj deklaratë, është/janë e/të vërtetë/a dhe

e/të saktë/a me sa di dhe me sa besoj.

Më është dhënë gjithashtu një kopje e Rregullit 91 të Rregullores së Procedurës dhe

të Provave të Tribunalit në një gjuhë që unë e kuptoj dhe kuptoj se mund të ndiqem

penalisht për dhënie të dëshmisë së rreme, në qoftë se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave

sime/të mia të shkruar/a nuk është/janë e/të vërtetë/a dhe e/të saktë/a.

Bërë më: 14.03.2002

Në: GJAKOVË, KOSOVË

Martin Pnishi

Nënshkrimi i dëshmitarit

Richard Rogers
Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesues



Rule 92bis

K0222419

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË
PREJ VITIT 1991

DEKLARATA E DËSHMITAR-IT/-ES

TË DHËNAT PËR DËSHMITAR-IN/EN:

Mbiemri: **PNISHI**

Emri: **Martin**

Emri i babait: **Kolë**

Nofka/Pseudonimi:

Gjinia: **Mashkull**

Datëlindja: **9 mars 1944**

Vendi i lindjes: **Ramoc, Komuna e Gjakovës,
Kosovë**

Përkatësia etnike: **Shqiptar** Feja: **Katolik**

Gjuhët e folura: **Shqip dhe serbo-kroatisht**

Gjuhët e shkruara (po qenë të tjera nga të folurat):

Gjuha/gjuhët e përdorur(a) gjatë intervistës: **Anglisht dhe shqip**

Profesioni i tashëm: **Bujk**

Adresa: **Mejë, Komuna e Gjakovës, Kosovë. Tel. 29682**

Pika e kontaktit: **Si më sipër**

Data(t) e intervist-ës/-ave: **4 prill 2000**

Vendi i intervistimit: **Mejë, Komuna e Gjakovës, Kosovë**

Intervistuesi: **Paolo PASTORE STOCCHI** Përkthyesi: **Illir SELMANMUSAJ**

Emrat e të gjithë njerëzve të pranishëm gjatë intervist-ës/ave: **Asnjë**

Nënshkrimi i dëshmitarit:

Të tjerët të pranishëm:

/nënshkrimi/

/nënshkrimet/



R

K0222420

DEKLARATË E DËSHMITARIT

Quhem Martin PNISHI, kam lindur në Ramoc, komuna e Gjakovës. Jetën e kam kaluar në Mejë ku jetoj edhe tash. Punoj si bujk në fermën time. Jetoj bashkë me tre bijtë e mi, Gencin 29 vjeç, Antonin 25 vjeç dhe Markun 23 vjeç; me gruan time Lushen, 52 vjeçe, bijën time Valbonën, 19 vjeçe, me renë time Verën, 29 vjeçe, me Verën, 22 vjeçe, /si në orgjinal/ me mbesën time të vogël Sabinën, 3 vjeçe, dhe me nipin tim Dominikun, 3 javësh.

Më 22 prill 1999, pesë policë serbë nga MPB-ja e Gjakovës u vranë në fshatin Mejë rreth orës 1700. Një nga viktimat ishte Millutin PRASHÇEVIQI, shëf i Ekipit Kriminal të MPB-së në Gjakovë. Pesë policët ishin në një veturë dhe kur arritën rreth 150 metra përtej livadhit të Shyt Hasanajt u sulmuan dhe u vranë. Unë isha në shtëpinë time dhe së pari i dëgjova dy krisma, pastaj shumë të shtëna mitralozi. Më vonë mora vesh nga fshatarët e tjerë se policë të MPB-së ishin sulmuar dhe vrarë. Nuk e di kush e ka kryer këtë aksion.

Pas incidentit shumë fqinjë të mi erdhën në shtëpinë time për të gjetur strehim. Policia serbe ishin në rrugën e Mejës dhe qitnin me snajperë në drejtim të shtëpisë sime. E qëlluan dritaren e Gjeshit, vëllait tim, që është pranë shtëpisë sime. Plumbat e goditën po ashtu shtëpinë e Tomës, nipit tim. Me atë rast Gjeshin përpak s'e kanë kapur plumbat por fatmirësisht ai nuk u plagos. Me këtë rast unë isha në shtëpinë e Gjeshit ku kishte edhe 40 fshatarë të tjerë lokalë dhe disa refugjatë nga Morina. Ato ditë serbët po i dëbonin civilët nga fshatrat fqinjë. Shumë sish kishte në shtëpinë e vëllait tim.

Më kujtohet se tanket e UJ-së serbe ishin vendosur mbi kodrën e Çabratit, kishin zënë pozicion aty që tetë muaj. Ushtarët e UJ-së dhe policia ishin kudo në rajon. Rajoni ishte i okupuar tërësisht nga forcat serbe. Ishte një ditë, mendoj se ishte më 31 korrik 1998, kur i kam numruar 175 tanke të UJ-së që shkonin në drejtim të kufirit të Shqipërisë dhe në drejtim të fshatrave në rajon. Tri ditë më vonë serbët i sulmuan fshatrat Nec, Smolicë dhe Dobrosh.



UP

K0222421

Nga data 23 prill, bashkë me familjen time u larguam nga shtëpia jonë dhe shkuam për të qëndruar në fshatin e afërt Jahoc. Më 27 prill 1999 në orën 0600 të mëngjesit u ktheva bashkë me gruan në shtëpinë time për t'i ushqyer shtazët. I ushqyem lopët, derrat dhe pulat. Në atë moment erdhi djali im Marku. E pyeta pse erdhi. Më tha se erdhi të më ndihmonte t'i ushqej shtazët. Në orën 0700 pashë forca të UJ-së dhe të policisë që filluan të qitnin. Nuk e dija nga vinin të shtënat. Ata me siguri kishin marrë pozicionet gjatë natës. U ngjita lart në katin e dytë të shtëpisë sime. Nga aty pashë me mijëra ushtarë dhe forca të policisë që e kishin rrethuar rajonin.

Rreth orës 07:30 e pashë Kolë DUZHMANIN, një njeri nga fshati Korenicë. Atë natë ai qëndroi në shtëpinë e kushëririt të vet në Jahoc. Ai ishte në biçikletë dhe shkante në drejtim të Korenicës. Unë isha në katin e dytë të shtëpisë sime. Ata ia kishin drejtuar mitralozët. E ndalën para derës sime të oborrit dhe e pyetën këtë njeri se kush ishte pronari i shtëpisë. Kolë DUZHMANI iu përgjigj se ishte shtëpia e Martin PNISHIT. Ata e pyetën Kolën edhe për shtëpitë e vëllait tim. Dola jashtë dhe e hapa derën e oborrit. Ishin dy oficerë të MPB-së dhe dy ushtarë rusë. Policia më pyeti kush ishte brenda në shtëpi. U thashë se familja ime ishte brenda në shtëpi. Ata më thanë ta merrja familjen dhe të largohesha sepse do ta digjinin shtëpinë.

Vrapova shpejt drejt oborrit tim, gruaja ime ishte te hajati. E mora gruan dhe e vendosa në një karrocë. Policia më pyeti sa anëtarë të familjes kisha. U thashë se e kisha djalin dhe gruan e paralizuar. Dy prej tyre u ndalën në oborr afër hyrjes së shtëpisë. Kishin maska dhe uniforma të gjelbërta të larme. Njëri prej tyre kishte grada në uniformë, e kishte një yll dhe një shirit. Nuk pashë shenja në uniformë. E dija se ishin policë të MPB-së lokale, nuk ua di emrat. Dy të tjerët flisnin rusisht; ata kishin pantollona bojhiri dhe xhaketa njësoj si forcat paramilitare serbe. Kishin mitralozë dhe thika të mëdha.

Njëri nga ushtarët rusë më urdhëroi të hidhesha në bunar, në oborr. Refuzova ta bëja këtë. Pastaj më pyeti nëse biri im ishte anëtar i UÇK-së. Iu përgjigja se gruaja ime ishte e paralizuar dhe biri im kujdesej për të. Ushtari më shqelmoi në anën e djathtë të trupit. U rrezova për tokë dhe ai më shqelmoi përsëri. Biri im ishte një metër larg



P

K0222422

meje. Kolë DUZHMANI ishte në mes të shkallëve të hyrjes dhe po shikonte. Gruaja ime ishte e shtrirë në karrocë.

Ushtarët ia kërkuan birit tim letërnjoftimin. Ai ua dha dokumentin por meqë rusët nuk dinin të lexonin shqip ia kthyen. Në atë moment dikush i thirri rusët në radio dhe u tha në serbisht nëse ishte aty Gjelosh KOLA. Ushtari u përgjigj se ai ishte aty. Në të vërtetë Gjeloshi nuk ishte aty por rusët e ngatërruan emrin e Gjelosh DUZHMANIT me atë të Gjelosh KOLËS.

Pasi që u përgjigj ushtari rus, personi në anën tjetër të radios urdhëroi: "... **Uništi ga ...**" që do të thotë "... **Zhduke...**". Në atë moment dy ushtarët rusë dhe dy policët e MPB-së më lanë mua në tokë dhe e kapën Kolë DUZHMANIN dhe e çuan para derës së oborrit të vëllait tim. Në ndërkohë unë shkova në katin e dytë të shtëpisë sime dhe prej aty e pashë kur kunata ime Grisha e hapi derën e oborrit.

Ushtarët dhe policët e goditën me kondakë të mitralozëve. Grisha e kishte për dorë djalin e saj 12 vjeç, Kristën. Ushtarët iu kërcënuan djaloshtit të vogël me thikë dhe ia vunë atë në fyt. Bërtisnin se do ta prenin në fyt. Grisha e kapi djalin; ushtarët e goditën Grishën përsëri. Ajo e mori djalin dhe iku drejt rrugës kryesore ku iu bashkua kolonës së njerëzve të tjerë që tashmë ishin atje. Po qëndroja pranë dritares, dëgjova breshëri të shtënash që erdhën nga shtëpia e vëllait tim. E dita se e kishin vlarë Kolë DUZHMANIN. Në të vërtetë pas 19 ditësh kam shkuar në shtëpi dhe e kam gjetur kufomën e Kolës të shtrirë në kuzhinë. Kishte 17 vrima kudo në trup. Katër ushtarët ia vunë zjarrin shtëpisë së vëllait tim. Dëgjova të shtëna. Isha në shtëpinë time dhe nuk guxoja të dilja. Ishte rreth orës 0930 më 27 prill kur e pashë një turmë të madhe që po vinte nga fshatrat Guskë dhe Kamenicë. Pashë po ashtu njerëz duke ardhur nga drejtimi i Junikut që ishin nisur në drejtim të Mejës. Ecnin rrugës kryesore. Në këtë kolonë kishte njerëz nga 17 fshatra. Njerëzit ishin me traktorë, vetura, më këmbë dhe me qerre kuajsh.

Serbët kishin ngritur një postbllok ku kryqëzoheshin rruga për Mejë-Orizë dhe rruga kryesore për Gjakovë-Junik. Shtëpia ime gjendet 300 metra prej aty dhe shihja shumë nga pozita ime. Kishte forca të policisë me autobllinda, ushtarë të UJ-së dhe njësite



UP

K0222423

paramilitare në postbllok. E pashë se civilët detyroheshin t'i hidhnin në tokë letërnjoftimet. Dëgjoja gra e fëmijë duke klithur. Burrat detyroheshin të zbrisnin nga traktorët dhe veturat. Detyroheshin të shtriheshin me fytyrë nga toka me duar mbrapa kokës. Disa meshkuj u dërguan në shkollë që gjendet mu në hyrje të fshatit në anën e majtë. I mbyllën aty brenda.

Në orën 1030, të gjitha forcat, policia, ushtarët dhe paramilitarët u mblodhën nga të gjitha vendet afër shkollës. Kur e pashë këtë i thashë birit tim të ikte drejt Jahocit. E mora gruan, e tërhoqa zvarrë dhe shkuam në shtëpinë e kumbarës sim në Jahoc. Kur hymë në atë shtëpi njerëzit u gëzuan që na panë sepse besonin se na kishin vrarë të gjithëve. Nga ajo pozitë i pashë pesë policë që po shkonin nga shkolla në drejtim të Urës së Travës në Jahoc, 100 metra nga shtëpia ime. Policia po i shtynin shtatë djem të rinj që i detyronin të ecnin përpara. Asnjëri prej këtyre shtatë të rinjve nuk ishte më i vjetër se 25 vjeç.

Policia u ndalën te këndi i urës nga ana e Mejës. I rreshtuan të rinjtë; njëri polic shkoi në mes të urës derisa të tjerët qëndronin në anën e kundërt duke i ruajtur të rinjtë. Polici që ishte në mes të rrugës i vrau shtatë të rinjtë me mitraloz. Të shtatë viktimat ranë pa shpirt përtokë. Kjo ndodhi në orën 1145.

Familja u nda në pesë shtëpi të ndryshme në Jahoc. Mendova se njëri nga viktimat mund të ishte njëri nga bijtë e mi. Në orën 12:00 shkova për të parë te vendi i vrasjes. I ktheva viktimat për të parë nëse midis tyre ishte ndonjë nga bijtë e mi apo djali i vëllait tim. E pashë se të afërmit e mi nuk ishin midis viktimave, u largova nga ai vend dhe shkova në Jahoc në shtëpinë ku po qëndroja. Nuk i njoha asnjërin nga viktimat.

Vrasja ndodhi ditën e martë më 27 prill, kufomat janë marrë të dielën e ardhshme më 2 maj. Pashë disa romë kur i morën ato kufoma të cilat u vunë në një traktor.

Ndërkohë e pashë një kamion të madh që po shkonte në Mejë për të marrë kufomat. Kamioni vinte nga Gjakova, ishte rreth orës 08:00. Dy orë më vonë kamioni u kthye nga Meja dhe u takua me traktorin. Bashkë, të dy automjetet, u nisën në drejtim të varrezave publike të Gjakovës. Nuk i pashë kufomat në kamion. Në qershor, ditën e



K

K0222424

parë kur forcat e NATO-s e çliruan vendin shkova për të parë te vendi i ekzekutimit te varrezat e vogla afër livadhit të Shyt Hasanajt. Aty pashë gjurmë buldozeri dhe shenjat ku ishin djegur kufomat. Gjurmët e kufomave të djegura ishin shumë të qarta dhe kështu mund të vlerëzoja se rreth 74 veta ishin djegur aty. E kam njohur njërin nga romët i cili i priu ekipit që i mori shtatë kufomat afër urës; ai quhet Hamdi dhe është nga Brekoci. Ai i mblodhi kufomat bashkë me tre djemtë e vet. Hamdiu ka shkuar për Mal të Zi bashkë me romët e tjerë të cilët ishin përfshirë në veprime kundër popullit shqiptar të Kosovës. Unë qëndrova në Jahoc deri në fund të luftës.

Alfred MARKAJ, 30 vjeç, kumbari im nga Jahoci, e pa ekzekutimin afër urës bashkë me mua nga kati i tretë i shtëpisë së tij.

Dragutini, komandanti i policisë në Ponoshec ishte midis atyre që po i ndanin meshkujt nga gratë e fëmijët në Mejë-Orizë. E pashë atje, ai e vuri një veturë, që e kishte grabitur nga një fshatar nga Guska që quhej Martin DEDA, ne mes të rrugës te udhëkryqi afër shkollës. Nuk më kujtohet mbiemri i tij; e di se ishte nga Vitomirica në komunën e Pejës.

Uniformat e ushtarëve ishin të ndryshme, po mendoj se disa njësite të ndryshme ishin angazhuar në rajonin e Mejës. Kishte trupa të UJ-së, njësite të SHESHELIT dhe të ARKANIT, anëtarë të MPB-së dhe rezervistë të tjerë. Njësitet e SHESHELIT ishin krejt në të zeza me tre shirita të verdhë, të zi dhe të gjelbërt në mëngë dhe me shenja me shqiponjën dykrerëshe të SHESHELIT. Kishin bereta të zeza me shqiponjë të bardhë dykrerëshe anash. Ushtarët e ARKANIT kishin uniformë ushtarake bojhiri me shirita të kuq në supe dhe në mëngë. Ata kishin bereta të rumbullakta të kuqe. Disa prej tyre kishin shirita të kuq të lidhur në ballë. Ushtarët e MILLOSHEVIQIT (UJ) kishin uniforma të gjelbërta të larme me grada në supe. Ushtarët e thjeshtë nuk kishin kurrfarë gradash. Njësitet e SHESHELIT dhe ARKANIT arritën në rajonin e komunës së Gjakovës në tetorin e vonshëm më 1998.

Nënshkrimi i dëshmitarit:
/nënshkrimi/

Të tjerët të prannishëm:
/nënshkrimet/



K0222425

NP

VËRTETIM I DËSHMITARIT/DËSHMITARES

Kjo deklaratë prej 7 faqesh më është lexuar në gjuhën shqipe dhe është e vërtetë, me sa di dhe sa më kujtohet. E kam dhënë këtë deklaratë me vullnet të lirë dhe jam i vetëdijshëm se mund të perdoret në procedura juridike para Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë Prej Vitit 1991, dhe se mund të thirrem të jap evidencë publikisht para Tribunalit.

Nënshkrimi: / nënshkrimi /

Data: 4 prill 2000

Presiding
Officer

Rule 92bis

K0222426

VËRTETIM I PËRKTHYESIT

Unë, Ilir SELMANMUSAJ, perkthyes, vërtetoj se:

1. Jam i kualifikuar dhe i miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Më ka informuar Martin PNISHI se ai e flet dhe e kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e Martin PNISHIT, i cili dukej se e ka dëgjuar dhe kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.
4. Martin PNISHI ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë, të përkthyer prej meje, janë të vërteta, me sa di dhe sa i kujtohet, dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Data: 4 prill 2000

Nënshkrimi: /nënshkrimi/



K0222427

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË PREJ
VITIT 1991

TË DHËNAT PËR DËSHMITAR-IN/EN

Mbiemri: **PNISHI**

Emri: **Martin**

Emri i babait: **Kole**

Nofka/Pseudonimi:

Gjinia: **Mashkull**

Datëlindja: **09.03.44**

Vendlindja: **Ramoc, Komuna e Gjakoves**

Adresa: **Meje, Komuna e Gjakoves**

Telefoni: **0390/29682**

Përkatësia etnike: **Shqiptar**

Feja: **Katolike**

Gjuhët e folura: **Shqip dhe serbokroatisht**

Gjuha/ët e përdorur(a) gjatë intervistës: **Shqip dhe anglisht**

Profesioni i tanishëm: **Bujk**

i mëparshëm: **Bujk**

Data e intervistës: **14 mars 2002**

Intervistuesi: **Kenneth EKDAHL**

Përkthyesi: **Ilir SELMANMUSAJ**

Emrat e të gjithë njerëzve të pranishëm gjatë intervistës/ave: **Kenneth EKDAHL, Ilir SELMANMUSAJ, Richard ROGERS, dhe Martin PNISHI**

Nënshkrimi: / nënshkrim /

Inicialet

(Dëshimtare)

(Të tjerë të pranishëm)

Martin Pnishi

[Signature]



K0222428

DEKLARATA E DËSHMITARIT

Unë kuptoj që më kërkohet të përshkruaj gjëra të cilat i di sepse i kam parë ato dhe do të tregoj qartë në deklaratën time fakte që i kam mësuar nga të tjerët.

Ne lidhje me deklaratën time të datës 4 prill 2000, dhene hetuesit Paolo Pastore STOCCHI, të përkthyer në gjuhën shqipe, të quajtur 92 bis, deshiroj t'i bëjë këto përmirësime:

Faqe 4, paragrafi 2, emrat duhet të jenë Kole DUZHMANI dhe Gjeloš KOLA.

Faqe 4, paragrafi 4, emri i fshatit duhet të jetë Korenice e jo Kamenice.

Faqe 4, paragrafi 5, shtëpia ime gjendet 200 metra e jo 300 metra.

Faqe 5, paragrafi 5, kamioni prej Mejës ka shkuar në Korenice. Pesë ditë pasi që kamionat u ngarkuan me kufoma Hamdi ALITAJ erdhi në shtëpinë time kinse për të kërkuar një kose, por unë mendoj se atë e derguan serbet që të kontrollojnë se a jemi në shtëpi apo jo dhe më tha se të dielën ishin ngarkuar 412 kufoma në kamione dhe traktore.

Faqe 6, paragrafi 1, mbiemri i Hamdiut është ALITAJ dhe djemte të tij quhen Halit dhe Sahit.

Faqe 6, paragrafi 3, emri i komandantit të policisë në Ponoshec është Dragutin STANOJEVIĆ i quajtur "GUTA".

Gjithashtu kam deklaruar, mirepo nuk është përfshirë në deklaratë, se e kam parë Predrag STOJANOVIĆ duke i vrarë 7 persona të Ura e Jahocit më, 27 prill 1999.

FUNDI I DEKLARATËS

Martin Prishi

[Handwritten signature]



K0222429

VËRTETIM I DËSHMITARIT/DËSHMITARES

Kjo deklaratë prej tri faqesh më është lexuar në gjuhën shqipe dhe është e vërtetë, me sa di dhe me sa më kujtohet. Kam dhënë këtë deklaratë me vullnet të lirë dhe jam i vetëdijshëm se mund të perdoret në procedura juridike para Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë Prej Vitit 1991 dhe se mund të thirrem për të dhënë dëshmi publikisht para Tribunalit.

Nënshkrimi: /nënshkrim/

Martin Prizmi

[Handwritten signature]

Presiding
Officer



Rule 62bis